



PROGRAMET E  
PËRGJEGJËSISË SOCIALE

Lufra ndërmerr  
hapa për një të  
ardhme më të mirë!

Prezantuar nga:  
Lufra sh.p.k



# Fjala e Presidentit

Vizioni ynë është të bëjmë produktet 'Made in Albania' të dëshiruara dhe të besuara në të gjithë botën!

Ne besojmë fort në vizionin dhe vlerat tona. Çdo hallkë e biznesit tonë mbron parimet etike, besimin dhe transparencën. Pikërisht mbi këto parime, ngrihen edhe programet tona për përgjegjësinë sociale. Mbajtja e premtimeve, është një element që na diferencon në treg, ne kurrë nuk shkelim fjalën e dhënë!

**Z. Arben Ndreka**



A close-up photograph of a brown and white cow with curved horns, eating hay from a large pile. The cow is in a stable, with metal bars and chains visible in the background. The lighting is warm and natural, highlighting the texture of the hay and the cow's fur.

Në themel të

# Vlerave tona

Në kompaninë Lufra, ne punojmë për një të ardhme më të mirë për të gjithë komunitetin dhe brezat që do vijnë. Për këtë arsye ne kemi hartuar një program për mbrojtjen e mjedisit dhe përgjegjësinë sociale.



## Çdo ditë e jona është një përpjekje për të dhënë më të mirën për konsumatorët tanë, por jo vetëm.

Nga programet e edukimit, tek mbështetja e fermerëve, reduktimi i mbetjeve e të tjera do mund ti ndiqni në vijim.

Një nga shtyllat e themelit në kompaninë tonë janë fermerët dhe përgjegjësia jonë sociale fillon nga ferma. Siç ju e dini, kërkesa për standarte të larta të lëndës së parë (qumështit), ndaj fermerëve është konsistente dhe vjen duke u shtuar. Përveç kësaj ne dëshirojmë që fermat të punojnë në harmoni me mjedisin dhe komunitetet përreth.



# Programi Cow Care

Përkujdesja  
ndaj lopëve

Ky program mbështetet nga trajnimet për përbërjen e ushqimit të lopëve, higjenën e tyre dhe mbajtjen e temperatures së duhur në stalla përgjatë të gjithë vitit.

Fermerët tanë i janë nënshtruar trajnimeve të ndyshme për të zhvilluar aftësitë e tyre në këtë drejtim dhe janë udhëzuar në praktikë për aplikimin e njohurive në trajnime.

Përveç trajnimeve, ne kemi vendosur personel të dedikuar si mjekë veterinerë që përkujdesen për shëndetin e lopëve dhe i japin këshilla fermerëve.

# Programi Tetra

Paketimi në karton

Paketimi i produkteve luan një rol të rëndësishëm në mbajtjen e produkteve të sigurta, parandalon shpërdorimin e ushqimit dhe mbron mjedisin.

Po ashtu paketimet e disa prej produkteve “Lufra” kërkojnë më pak energji në prodhim e si rrjedhojë kontribuojnë në pakësimin e energjisë së shpenzuar.

Për këtë arsye “Lufra” punon me “Tetrapack” për paketimet në karton, të cilat janë më higjeniket në planet!



# Programi Optimal Production

Optimizimi i prodhimit

Në punën tonë ne përpiqemi maksimalisht për optimizimin e proceseve të prodhimit duke automatizuar të gjitha proceset nëpërmjet teknologjive bashkëkohore. Kjo ka sjellë edhe reduktimin e sasisë së mbetjeve, e cila do ishte shumë e lartë nëse proceset do kryheshin të gjitha nga fuqia punëtore dhe jo nga makineritë precize. Nga viti 2012 e deri ne vitin 2021 e kemi reduktuar emetimin e mbetjeve me 30%.



# Ne dëgjojmë!

Pjesë e këtij programi janë edhe të gjitha paketimet e produkteve “Lufra”. Një paketim cilësor, është esencial për ruajtjen e freskisë dhe jetëgjatësisë së produktit në frigorifer. Produktet tona janë shumë të lehta për tu përdorur dhe përcaktimi i sasisë që përmbajnë produktet përcaktohet nga konsumatori.

Po, konsumatori përcakton se cila është sasi në litra ose gramë që dëshiron të konsumojë. “Lufra” ka kryer shumë studime tregu dhe zërin e konsumatorëve e ka përkthyer në produkt.

Në rastin e Qumështit të freskët “Lufra” ka pare se konsumatorët dëshirojnë formatin 1.4L por ka edhe konsumatorë që dëshirojnë 1L. Për të eliminuar shpërdorimin e produktit nga ana e konsumatorëve, “Lufra” ka sjellë në treg edhe formatin 1L të qumështit.

# Programi

## Education is key

Edukojmë konsumatorët për përdorimin e produkteve të bulmetit dhe mos shpërdorimin e ushqimit.



Nëpërmjet këtij programi ne inkurajojmë konsumatorët të përdorin produktet në mënyrën më të përgjegjshme të mundshme, duke mos shpërdoruar apo hedhur ushqimin. Ne jemi koshientë për sfidat e shumë familjeve për të siguruar ushqimin e përditshëm.



# Programi Mother Nature

Mirënjohës ndaj  
nënës natyrë!

Në “Lufra” besojmë se marrëdhënia me natyrën është simbiotike dhe i jemi shumë falenderues për çfarë na ofron.

Natyra është gjeneza e prodhimit të produktit, prodhimit të ujit, riciklimit dhe vijimësisë së jetës.

Është në ambiciet tona, tu tregojmë të gjithëve se profesioni i fermerit është i mrekullueshëm dhe se brezat e ardhshëm duhet ta kultivojnë me dashuri.

Po ashtu, impianti i pastrimit të ujërave dhe mbetjeve tokësore të fabrikës dhe kaldaja ekologjike me biomasë ulin ndotjen e tokës dhe ajrit në masën minimale.

# Programi In nutrients we trust

Vlerat ushqyese të produkteve tona janë të pazëvendësueshme

Asnjë nga produktet tona nuk përmban sheqer të shtuar. Produktet tona janë shumë të shëndetshme dhe përdoren nga e gjithë familja.

Për konsumatorët që nuk dëshirojnë të konsumojnë yndyrë, Lufra ka sjellë edhe produktet me 0.5% yndyrë si Kosi dhe Qumështi!

Në produktet Lufra nuk ka konservantë, shtesa ushqimore apo ngjyres, ato janë 100% natyrale.



# Programi Supporting the community

Mbështjetja ndaj komunitetit

“Lufra” ka dhënë kontribut të madh në punësimin e banorëve të zonave përreth fabrikës, por edhe të punonjësve në të gjithë Shqipërinë.

Por jo kaq, prej vitesh ne bashkëpunojmë me furnitorë dhe kompani shqiptare për materialet e nevojshme dhe investon në bashkëpunimin me to. Jo pak herë, “Lufra” ka ndihmuar familjet në nevojë nëpërmjet ndihmave ushqimore dhe financiare, në bashkëpunim me organizata bamirëse në Shqipëri.

Barazia gjinore dhe mbështjetja ndaj familjes është një ndër pikat mbi të cilat “Lufra” po punon me UNFPA.

Shëndeti dhe siguria e punonjësve në kompaninë tone është prioritet, për këtë arsye përveç trajnimeve ne kemi siguruar ambiente pune të sigurta e miqësore.





# TË KRIJOSH IMPAKT!

Për produktet "Tradi'a" të prodhuara nga "Lufra", 5 lekë të çdo produkti të shitur, shkojnë për Fondacionin "Bujqësia dhe Blegtoria Shqiptare" në ndihmë të fermerëve. Ky është një fondacion i krijuar nga themeluesit e kompanisë "Lufra" për të mbështetur fermerët!



"Ne kemi kuptuar se mes nesh dhe fermerëve duhet të egzistojë një marrëdhënie e ngushtë dhe e sigurtë, për të mbështetur, nxitur dhe orientuar modernizimin dhe zhvillimin e sektorit të blegtorisë.

Fermerët tanë janë shumë krenarë kur shohin se produktet Lufra eksportohen edhe përtej Oqeanit, në SHBA." – thotë Z. Luis Ndreka, administrator i kompanisë "Lufra".



# Programi Visit us

Ne mbështesim edukimin dhe transparecën, për këtë arsye ne ftojmë vazhdimisht institucione arsimore, bashkëpunëtorë dhe grupe interesi për të vizituar ambientet e fabrikës.

Po ashtu konsumatorët nuk kanë asnjë pengesë për të vizituar fermat me të cilat ne bashkëpunojmë dhe të shohin nga vjen qumështi të cilin ne e përdorim për prodhimin e produkteve të bulmetit.



